



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Mbi zbatimin e auditimit financiar në Prokurorinë e Përgjithshme, Tiranë.

Përgatitur nga data 16.10.2020 deri më 30.10.2020.

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr. 809/1, datë 01.09.2020 “*Mbi auditimin Financiar*” për periudhën 01.01.2018 – 31.08.2020, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi sipas programit të auditimit nr. 809/1, dt. 01.09.2020 ka filluar në datën 01.09.2020 dhe ka përfunduar në datën 16.10.2020.



	PËRMBAJTJA E LËNDËS	Faqe
I.	HYRJA (Të dhënat mbi raportin e auditimit)	3-7
	a. Objektivat dhe qëllimi.	
	b. Identifikimi i çështjes.	
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	d. Përgjegjësitë e audituesve	
	e. Kriteret e vlerësimit	
	f. Standardet e auditimit.	
	g. Metodatat e auditimit	
	i. Dokumentimi i rezultateve të auditimit.	
II.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	7-9
III.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	9-50
	1. Auditimi i pasqyrave financiare.”	
	a. Auditimi i pasqyrave së pozicionit financiar	
	b. Auditimi i pasqyrës së performancës financiare	
	c. Auditimi i pasqyrës financiare individuale e flukseve monetare.	
	d. Auditimi i pasqyrës së aktiveve neto/fondet neto.	
	e. Shënimet dhe relacioni për llogaritë.	
IV.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.....	50-53
V.	ANEKSE I-V.....	55-60

**I. Hyrja.**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditori veprimtarinë e Prokurorisë së Përgjithshme, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, dhënia e opinionit (viti 2019) për saktësinë e paraqitjes së zërave të aktivit e pasivit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit.

Auditimi u krye me zgjedhje për periudhën 01.01.2019, deri 30.08.2020.

Bazuar të dhënave të marra në subjekt, fondet e trajtuar, botimet në mediat e shkruara, ndjeshmërinë publike dhe të grupeve të interesit, riskun, u identifikuan fushat e auditimit të cilat lidhen me pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjet dhe daljet*), pagesat në para, pasqyra e amortizimit, pasqyra e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

a) Titulli:

Raport Përfundimtar i Auditimit financiar në Prokurorinë e Përgjithshme,

b) Marrësi:

Ky Raport Përfundimtar i adresohet Prokurorisë së Përgjithshme.

c) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, *nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare të vitit 2019, janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar*, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejtë me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Objektivat e këtij auditimi konsistojnë në:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.*

-*Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.*

-*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.*

Për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare audituesi të arrijë në përfundimin se është arritur siguria e arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Ky përfundim merr në konsideratë vlerësimin e audituesit për anomalitë e pakorrigjuara në pasqyrat financiare, nëse ka të tilla.

Një anomali shfaqet si një diferencë midis shumës, klasifikimit, paraqitjes, ose informacionit shpjegues të dhënë për një element ose një shumë të pasqyrës financiare të raportuar dhe shumës, klasifikimit, paraqitjes apo informacionit shpjegues të dhënë që kërkohet të jetë për elementin për të qenë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

d) Identifikimi i çështjes: Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare në Prokurorinë e Përgjithshme, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara si edhe shoqërohen me relacion shpjegues (si lista e



kreditorëve, e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive).

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit nr. 809/1, datë 01.09.2020 “*Mbi auditimin Financiar*” në Prokurorinë e Përgjithshme për periudhën 01.11.2018 – 30.08.2020,

Baza Ligjore:

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 1000-2999 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”;

-ISSAI 1300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”

-INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*”; INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm*”;

-Në praktikat më të mira të fushës si: (*Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC, Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve*),

-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”,

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar,

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*”.

- UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre*”

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:

Sekretari i përgjithshëm (*Nëpunësi autorizues i komanduar*), Drejtori i Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve (*Nëpunësi zbatues i komanduar nga muaji mars 2020*), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (*apo në përputhje*) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm që është relevant në entitet, në mënyrë që të programonim procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.



g) Kriteret e vlerësimit:

Ligji nr. 154/2014, datë 23.12.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”;

- Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si më poshtë:

ISSAI 1000-2999 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

ISSAI 1300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”

INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;

INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

- Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS); si edhe praktikat më të mira të fushës¹;

- UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre”

h) Standardet e Auditimit:

Auditimi bazohet në Ligjin nr. 154/2014, datë 23.12.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”; Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

- ISSAI 100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

-INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”; INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën **2%** për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin Prokuroria e Përgjithshme, **niveli i materialitetit për vitin 2018 rezultoi 4,621,953 lekë, dhe për vitin 2019 niveli i materialitetit rezultoi 5,954,179 lekë².**

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet **testeve të kontrolleve**. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri të moderuar.

¹ Standardet për Kontrollin e Brendshëm të COSO-s; Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;

² Shiko Aneksin 1



Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon e konkretisht:

$\text{Risku i Auditimit} = \text{Risku i qënësishëm} * \text{Risku i kontrollit} * \text{Risku i Zbulimit}$
--

Nisur sa sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jofinanciar si psh krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në letër ose elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë.

Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Kontrolli i brendshëm:

Kontrolli i brendshëm në institucion nëse ka funksionuar i plotë, përfshin tërë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike a mund ta dijë ku mundet të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet a ka të konfirmuara (*Rakorduara*) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Inventarizimi i aktiveve:

Nga Prokuroria e Përgjithshme për vitet 2018, 2019 a janë kryer inventare e kontrole për ekzistencën dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktivet afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës si përcakton UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Transaksionet:

Gjatë vitit 2018 dhe 2019 në periudhën e fundit të vitit ushtrimor a konstatohen se janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë dhe nisur nga ky fakt bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur kryhen filtrimet e tyre:

Me qëllim që Urdhër Shpenzimet e filtruara të auditohen në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

**Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:****1. Kontrolli aritmetik.**

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese *(Urdhër shpenzimeve)* konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët,

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara *(Rakorduar)* me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.*

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit ProjektRaporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Me shkresën nr.1318/2 datë 07.12.2020 miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme, është kthyer përgjigja mbi projektraportin e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit e cila citon se “*Në përgjigje të shkresën tuaj nr.802/2 datë 13.11.2020, me të cilën është dërguar ProjektRaporti i Auditimit, ju informojmë se pasi u njohëm e gjejmë atë të pranueshëm dhe nuk kemi komente për të shtuar*”.

II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**1. Informacioni i përgjithshëm:**

Prokuroria është organ kushtetues organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me dispozitat e pjesës së dhjetë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “Prokuroria” dhe ligjit organik nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ku janë parashikuar funksionet e saj si, organi që ushtron ndjekjen penale, përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara në ligj.



Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor. Ajo i ushtron funksionet në mënyrë të pavarur nëpërmjet prokurorëve. Sipas Kushtetutës misioni i organit të akuzës është: të zhvillojë hetime dhe ndjekjen penale të përfaqësojë në emër të shtetit, akuzën në gjyq, të mbrojë interesat publike, t'u vijë në ndihmë organeve të drejtësisë si dhe të garantojë zbatimin e ligjit.

Më poshtë po paraqesim disa nga gjetjet kyçe të auditimit:

- Nga auditimi rezultoi se, Prokuroria e Përgjithshme nuk është e përfshirë në sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Mbajtja e evidencës kontabël të kësaj njësie publike bëhet me programin Alfa. Mospërfshirja në sistemet e reja IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) ku mund të mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit; të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike; të dhëna për raporte financiare dhe statistika; etj, nuk mundëson mbajtjen e të dhënave të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit; në përputhje me bazën ligjore për financat publike për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.

-Për vitet 2018-2019, mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës truall në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, (zëri “toka, troje e terrene”), në analizë aktivet (neto):

Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata jo materiale” në llog. 210 “toka troje terren” është pasqyruar në vlerën 0 lekë e pasaktësuar në sasinë dhe në vlerën 161,355,109 lekë të saj, referuar vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), zona kadastrale nr. 150, përcaktohet me çmimin prej 66,969 lekë/m².

- Për vitet 2018-2019, evidentohet mungesa e evidencave kontabël të sakta lidhur me vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale; “studime dhe kërkime”. Në analizë aktivet (neto): Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata jo materiale” në vlerën 755 000 lekë janë të pasqyruara në llog. 202 “Studime dhe kërkime” e pasaktësuar sipas zërave çfarë përfaqëson dhe nuk rezultojnë të ketë as evidencë kontabël për këto zëra.

Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata jo materiale” në vlerën 783 100 lekë janë të pasqyruara në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” e pasaktësuar sipas zërave çfarë përfaqëson dhe nuk rezultojnë të ketë as evidencë kontabël për këto zëra.

- Nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 107, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale”, i përmirësuar, në analizë aktivet (neto): Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera bruto e studimeve dhe projekteve, përkatësisht prej 755 000 lekë. Për këtë vlerë nga ana e Sektorit të Financës nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara

Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata jo materiale” në vlerën 783 100 lekë janë të pasqyruara në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Për këtë vlerë nga ana e Sektorit të Financës nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara

- Për vitet 2018-2019, mungon analiza e llog. 468 “debitore të ndryshëm” në vlerën 3,803,861 lekë, në analizë aktivet (neto):

Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “llogari të arkëtueshme” janë të pasqyruara në llog. 468 “debitore të ndryshëm” në vlerën 3,803,861 lekë, vlerë e cila nuk rezultojnë të jetë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pashpresë arkëtimi, duke ndjekur të gjitha hapat dhe shkallët ligjore për arkëtimin e tyre.



-Për vitin 2018 procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”. Nga ana e komisionit të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, për vitin 2018 numri i këtyre artikujve të dëmtuar është 88 dhe vlera monetare e tyre është 7,365,350.88 lekë, Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, pasi *nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit mbi informacionet e grupeve të inventarizimit*.

-Në llogarinë ekonomike 105 “*Grantet e brendshme kapitale*” të formatit 4, është paraqitur vlera 84,674,131 lekë, të cilat janë përdorur nga institucioni për shpenzimet e aktiveve afatgjata materiale (llog.231). Në të dhënat e tabelës së akt rakordimit të shpenzimeve me thesarin për 12 mujorin, paraqitet vlera 80,836,378 lekë. Në (llog.1059) “*Grante të brendshme kapitale në natyrë*” jepet vlera 4,349,161 lekë. Shuma e të dhënave të akt rakordimit të thesarit për 12 mujorin me grante të brendshme kapitale në natyrë është 85,185,539 lekë. Kjo vlerë nuk rakordon me vlerën e granteve të brendshme kapitale, por ka një diferencë me 511,408 lekë.

- *Pyetësi dhe shënimet shpjeguese* për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në informacionin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2018 dhe 2019, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive po ose jo, ashtu si edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse.

- Prokuroria e Përgjithshme ka hartuar si dhe miratuar nga PP Rregulloren e brendshme të institucionit me urdhrin nr. 235 datë 02.11.2018 “*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme*”. Nga auditimi u konstatua se nuk janë reflektuar ndryshimet të cilat kanë ardhur si rezultat i ndryshimit të organikës me urdhrin nr.29 datë 03.02.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “*Për disa ndryshime ne urdhrin nr.22 datë 07.02.2019 mbi Strukturën dhe Organikën e PP*”.

Në mënyrë të përmbledhur rezultatet e auditimit, konstatimet dhe gjetjet si më poshtë:

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

a. Auditimi i pasqyrave të pozicionit financiar viti 2018; nëse Pasqyra (Pasqyra nr. 1) individuale e pozicionit financiar (bilanci kontabël) pasqyron në mënyrë të klasifikuar e strukturuar aktivet, detyrimet dhe fondet neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues.

Nga auditimi u konstatua se:

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

Pasqyrat financiare për vitin 2018 janë hartuar dhe depozituar me shkresën nr. 881 datë 25.03.2019 brenda afatit ligjor.

Pasqyrat financiare kanë të plotësuar; pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare ose pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; pasqyrën e flukseve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. Pasqyrat financiare vjetore janë shoqëruar me pasqyrat statistikore, si pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre, pasqyra



mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto dhe pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës dhe të ndryshme.

Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhornuar, si dhe i llogarive inventariale të magazinës dhe është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Auditimi i aktiveve afatgjata:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve afatgjata; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte. Nëse aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre. Lidhur me këto aktive, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nëse kanë analizuar e rakorduar investimet e tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e ndërmarrjeve të tjera (publike ose jopublike). Për këtë qëllim, nga njësia a janë saktësuar regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar.

b. Kontrole të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve afatgjata, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata;

U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostonë së tyre të prodhimit.

- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2018 rezultoi:

Në analizë aktivet:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata materiale” në vlerën 451 832 mijë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
42		II.AKTIVET AFAT GJATA	451 832 189	581 785 782
43	20	2. Aktivet afatgjata jo materiale	1 661 600	1 661 600
	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
	202	Studime kerkime	755 000	755 000
	203	Koncesione,patenta,licenca të ngjashme	906 600	906 600
47	21,23,24,28	2. Aktivet afatgjata materiale	451 170 589	580,124,182
48	210	Toka, troje, terrene		
49	211	Pyje, plantacione		
50	212	Ndërtesa e konstruksione	97 487 311	149 662 850
51	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	783 100	783 100
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	268 647 681	332 767 466
53	215	Mjete transporti	16 639 531	19 782 475
54	216	Rezerva shtetërore		
55	217	Kafshë pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	66 612 966	77 182 291
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara		
58	28	Caktime të aktiveve afatgjata		
59	25-26	3. Aktive afatgjata financiare	0	0
60	25	Huadhënie e nënhuadhënie		
61	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		

Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) për vlerën 97,487 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer, por duhet të theksojmë se pavarësisht se kryhet regjistrimi kontabël i vlerës së ndërtesës dhe llogaritët amortizimi i saj, rezulton se ndërtesa dhe trojet rreth saj janë pronë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme i ka vetëm në administrim, vlere kontabël e regjistruar në fakt nuk paraqet vlerën reale të tregut apo të zonimit hartografik sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas FZ nr.14, viti 2016, faqe 961)

Nga auditimi konstatohet se Llogaria 210, “Toka, troje e terrene” është e kontabilizuar për të dy vitet më shumë të njëjtë, në vlerën zero lekë,

210	Toka, troje, terrene	0	0
-----	----------------------	---	---

Nga auditimi i të dhënave të raportuara nga ana e Prokuroria e Përgjithshme në Ministrinë e Brendshme (shkresa nr. 3096 prot, datë 24.11.2006), *Për inventarin e pronave publike në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme*, rezulton se, për artikujt me nr. 31-32-34 të Formularit nr. 1 për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, është evidentuar sipërfaqja prej 3310 m2, e cila detajohen sipas objekteve si vijon:

Nr.	A			B			Nr. I kateve i shoqëruar me sipërfaqen çdo kati (m²)	Institucioni përdorues Statusi juridik i përdorimit	Institucioni me përgjegjësi administrativ
	Zona kadastrale & Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sipërfaqja totale e pronës (shesh + objekt) (m²)	Sipërfaqja vetëm e objektit (m²)			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	8150 TR – H,I – 17	2/25	Truall-Ndërtese	Prokuroria e Përgjithshme Rr. Qemal Stafa	3022 m²	612,6m²	5 kate	Prokuroria e përgjithshme	Prokuroria e Përgjithshme
			Garazh ndërtesë Prok e krimeve te renda		288 m²				
					3310 m²	612,6 m²			



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME


Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Referuar formularit për inventarizimin e pronave të veçanta, rezulton se sipërfaqja totale e pronës (shesh + objekt) është 3022 m².

Në mënyrë të detajuar, sipërfaqet e objekteve dhe trojeve, tokave e terreneve si vijon:

Sipërfaqja totale e pronës	- 3 310 m ²
- Sipërfaqja e garazhit	e pa saktësuar
- sipërfaqja totale ndërtimi	- 612.6 m ²
- Sipërfaqja e gjelbërimit	- e pa saktësuar/m ²
- sipërfaqja e rrugëve dhe shesheve	- e pa saktësuar m ²

Konstatohet se, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve si dhe vlera e tyre në vitin 2018-2019, nuk janë regjistruar në bilancin kontabël, (ku është evidentuar për vlefshëm gjithsej 0 lekë). Sipërfaqja totale e tokës që ka Prokuroria e Përgjithshme në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas FZ nr.14, viti 2016, faqe 961) referuar vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), zona kadastrale nr. 8150, përcaktohet me çmimin prej 66,969 lekë/m².



Për sa sipër,

Nga përlllogaritjet për tokën truall duke i zbritur sipërfaqen e ndërtesës (3022-612.6m²) prej 2409,4 m² x çmimin për zonën kadastrale nr. 8150, në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016 prej 66,969 lekë/m² = 161,355,109 lekë, vlerë e cila nuk është pasqyruar në kontabilitetin e Prokurorisë së Përgjithshme.

Është hartuar formulari për inventarizimin e pasurive të paluajtshme shtetërore, dokumentacioni lidhur me planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që Prokuroria e Përgjithshme ka në dispozicion, plani i rilevimit (kadastral dhe topografik), plan vendosjet me rrjetin koordinativ dhe ortofoton përkatëse, planimetritë për secilin objekt dhe për çdo kat dhe si janë organizuar

Mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës truall në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, (zëri “toka, troje e terrene”), ku duhet të ishte pasqyruar vlera prej 161,355,109 lekë, shifër kjo e konsideruar materiale për auditimin e pasqyrave financiare, nga 0 lekë, sa pasqyruar në bilancin e periudhës që auditohet.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Titulli i gjetjes 1:	Për vitet 2018-2019, mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës truall në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, (zëri “toka, troje e terrene”),
Situata1:	Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës-truall në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, më konkretisht në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata materiale”, llogaria 213 “Toka troje terren” është pasqyruar në mënyrë jo të saktë, në vlerën 0 lekë. Grupi i auditimit konkludoi se, referuar çmimeve të publikuara, ³ vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë-truall, për qytetin e Tiranës, për zonën kadastrale nr. 8150, përcaktohet me një çmim prej 66,969 lekë/m ² , nga ku për sipërfaqen prej 2409,4 m ² që ka prona në fjalë, rezulton një vlerësim prej 161,355,109 lekë.
Kriteri:	Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, (Harta sipas FZ nr.14, viti 2016, faqe 961) referuar vlerës së pasurisë së paluajtshme të llojit tokë truall për qytetin e Tiranës, (referuar çmimeve të vitit 2014), zona kadastrale nr. 8150.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje lidhur me këtë zë, në rregjistrat kontabël.
Rëndësia	I lartë
Rekomandime	Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale “Toka troje terren”, në administrim të institucionit Prokuroria e Përgjithshme. Nga Sektori i Financës të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës

Zëri “Rrugë, rrjete, vepra ujore” (llog. 213) për vlerën 783,100 mijë lekë nuk është i zbërthyer në mënyre analitike dhe nga i cilat objekte përbehet dhe i parakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” (llog. 214) për vlerën 268,647 mijë lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Mjete transporti” (llog. 215) është për vlerën 16,639 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218) për vlerën 66,612 mijë lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Titulli i gjetjes 2:	Për vitet 2018-2019, evidentohet mungesa e evidencave kontabël të sakta lidhur me vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale; “studime dhe kërkime”.
Situata1:	<u>Në analizë aktivet (neto):</u> Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, evidentohet mungesa e evidencave kontabël të sakta, lidhur me vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale; “Studime dhe kërkime”. <u>Konkretisht për llogaritë</u> 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 755 000 lekë, dhe 213 “Rrugë,

³ <https://geoportal.asig.gov.al/sq/dhenat>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

	<i>rrjete, vepra ujore</i> ”, në vlerën 783 100 lekë, si pasojë e mungesës së evidencave kontabël, nuk arritëm të sigurojmë informacion mbi llojin dhe natyrën e zërave që janë përfshirë në llogaritë respektive duke vendosur institucionin përpara riskut që Pasqyrat financiare të mos sigurojnë të dhëna të plota dhe të nevojshme për vendimmarrjen, lidhur me këto zëra.
Kriteri:	Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “ <i>Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme</i> ”.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje lidhur me këtë zë, në regjistrat kontabël.
Rëndësia	I ulët
Rekomandime	Nga Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar me evidenca kontabël, llojin dhe natyrën e aktiveve afatgjata jomateriale/materiale në llogaritë përkatëse 202 “ <i>Studime dhe kërkime</i> ” dhe 213 “ <i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i> ”, për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të tyre. Në vijim, Sektori i Financës të marr masa për të kryer llogaritjet e amortizimit të këtyre aktiveve, me qëllim saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare.

- Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata:

Në pasqyrën anekse statistikore formati 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike*” kolona 2 “*blerje e krijuar me pagesë*” për vlerën 35 214 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve afatgjata, “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 858 960 mijë lekë, “*Inventar ekonomik*” në vlerën 34 355 880 mijë lekë,

Në kolonën 4 “*shtesa pa pagesa brenda sistemit*” për vlerën 4 349 161 mijë lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve, “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 330 960 mijë lekë, “*Mjete transporti*” në vlerën 2 499 600 mijë lekë dhe “*Inventar ekonomik*” në vlerën 1 518 601 mijë lekë,

Formati 7/a, kolona 9 pakësime gjatë vitit ushtrimor “*pakësime të tjera*” janë pasqyruar pakësime të aktiveve, “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në vlerën 237 600 mijë lekë, “*Inventar ekonomik*” në vlerën 5 727 164 mijë lekë, “*Mjete transporti*” në vlerën 2 470 800 mijë lekë.

Formati 7/a, kolona 7 pakësime gjatë vitit ushtrimor “*Nxjerrje jashtë përdorimit*” nuk ka pasqyruar pakësime të aktiveve, pavarësisht se nga inventarët e kryer evidentohen aktive për nxjerrje jashtë përdorimi por që nuk është kryer si proces (trajtuar më hollësisht te inventarët).

- **Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakoordimi me pasqyrat e tjera financiare.**

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 20) në formatin nr. 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike*” kolona 11 “*Gjendja në mbyllje të ushtrimit*” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*”, kolona 8 “*Kosto historike*” 1,709,000 lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/a “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike*” kolona 11 “*Gjendja në mbyllje të ushtrimit*” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*”, kolona 8 “*Kosto historike*” 450,170 589 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 20) në formatin nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” kolona 10 “Teprica neto” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Ushtrimi i mbyllur” llogaria 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 1,661, 600 mijë lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” kolona 10 “Teprica neto” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Ushtrimi i mbyllur” llogaria 20 “Aktive afatgjata materiale”, 451 832,189 mijë lekë.

Pasqyra krahasuese e pozicionit financiar me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata:

Në lekë

Llog.	Emërtimi	Ushtrimi paraardhës	Ushtrimi mbyllur	Formati 7/b, (Gjendja dhe ndryshimet)	Diferenca (4-5)
1	2	3	4	5	6
201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave	0	0	0	
202	Studime dhe kërkime	755 000	755 000	755 000	
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme	0	0	0	
210	Toka, Troje, Terrene	0	0	0	
211	Pyje, Plantacione	0	0	0	
212	Ndërtesa e Konstruksione	149,662 850	97,487,311	97,487,311	
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	783,100	783,100	783,100	
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	332,767,466	268,647,681	268,647,681	
215	Mjete Transporti	19 728 475	16 639 531	16 639 531	
216	Rezerva Shtetërore	0	0	0	
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0	
218	Inventar ekonomik	77 182 291	66 612 966	66 612 966	
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0	
28	Caktime të Aktiveve Afatgjata	0	0	0	
	TOTALI	581 785 782	451 832 189	451 832 189	

Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata mbi të cilat është aplikuar përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi (Pasqyra anekse statistikore Format 7/b) është e barabartë me:

- Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore; (vlera 854,281,592 lekë). Amortizimi i akumuluar 272 459 810 lekë.
- Shtesën e kostos së blerjes dhe kostos së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; (vlera 39 564 001 lekë). Amortizimi i llogaritur 433 577 840 lekë, si dhe

Amortizimi i vitit 2018 është 433 577 840 lekë.

Amortizimi i aktiveve afatgjata është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

36. Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;
- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sistemeve informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;
- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe
- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.



Nga auditimi i kartelës së llogarisë 209 “Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale” dhe 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale”, (formati nr. 1) dhe pasqyrës statistikore formati 7, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë:

Llog. Nr. 202 “Amortizim, studime dhe kërkime” = -47 400 lekë.

Llog. Nr. 212 “Amortizim ndërtime dhe konstruksione” = 60 120 892 lekë.

Llog. Nr. 213 “Amortizim Rruge, Ura, Rrjete, Rezervuare” = 0 lekë,

Llog. Nr. 214 “Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” = 178 086 300 lekë,

Llog. Nr. 215 “Amortizim Mjete transporti” = (42,606,891) lekë,

Llog. Nr. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” = (152,716,357) lekë.

Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera bruto e studimeve dhe projekteve, përkatësisht prej 755 000 lekë. Për këtë vlerë nga ana e Sektorit të Financës nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara që nga marrjen e këtyre shumave në llogarinë e aktiveve duke e evidentuar vit pas viti në po të njëjtën vlerë.

Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 107, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale”, i përmirësuar, ku përcaktohet se:

“Amortizimi është konstatimi kontabël i pakësimit të vlerës së një elementi të aktiveve të qëndrueshme që rezulton nga përdorimi, nga koha, nga ndryshimet teknike dhe nga çdo shkak tjetër, efektet e të cilëve janë të pakthyeshme (përfundimtare) për shkak të vështirësive të matjes së zhvlerësimit amortizimi konsiston, përgjithësisht, në shpërndarjen e vlerës së elementeve normalisht të amortizueshëm mbi të gjithë kohën e parashikuar të shërbimit të tyre.

Paragrafit nr.107: “Shpenzimet e amortizimit të AAM-ve dhe AAJM-ve, si dhe humbjet nga zhvlerësimi, paraqiten si zë më vete i formatit 1 të pasqyrës së performancës, si dhe në zërat përkatës të formatit 2, në varësi të funksioneve të aktiveve në njësinë ekonomike. Fitimet/humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të AAM dhe AAJM njihen në zërat “Shpenzime të tjera të shfrytëzimit”.

Paragrafit nr.110: “Një njësi ekonomike duhet të japë për AAJM informacionin e mëposhtëm shpjegues:

(a) Një përshkrim të vlerës kontabël neto dhe periudhës së amortizimit të çdo aktivi jomaterial që konsiderohet material për pasqyrat financiare të njësisë;

(b) Për aktivet jomateriale të përfuara nëpërmjet një granti të qeverisë dhe të njohur fillimisht me vlerën e drejtë:

(i) Vlerën e drejtë të njohur fillimisht për këto aktive; dhe

(ii) Vlerat kontabël neto të tyre.

Nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e Kapitulli III, Seksionit II, “Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara”, të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, ku në lidhje me regjistrimet kontabël për aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara përcaktohet se: “Ligji për “Për kontabilitetin” parashikon një kufizim të afatit për amortizimin e këtyre aktiveve (deri në 5 vjet) nisur nga rreziqet që mund t’i vijnë kreditorëve të njësisë ekonomike në rast të një falimentimi, sepse disa elemente janë të pashitshme (p.sh. shpenzimet e nisjes e të zgjerimit ¹), ose bëhen të pashitshme apo të pavlershme (p.sh. fondi tregtar). Megjithatë për elemente që gëzojnë një mbrojtje ligjore ose janë të lidhura me një element tjetër të trupëzuar amortizimi mund të bëhet në një afat më të gjatë”.

Aktivët afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues, llog. 31, zëri “Materiale” në shumën prej 27,427,560 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Aktivitet afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues llog. 32, zëri “*Inventari i imët*” në shumën prej 1 414 972 mijë lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

Në aktivin e bilancit kontabël “*Llogari të arkëtueshme*” pasqyrohen në bilanc Formati nr. 1 për vlerën 18 544 548 mijë lekë detyrime ku:

- “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” (llog. 423,429) zënë shumën 142 451 mijë lekë,
 - “*Debitorë të ndryshëm*” (llog. 468) në vlerën 3,803,861 mijë lekë përbëhen në analizë nga 26 persona debitorë për detyrimin në vlerën 2, 428, 215 lekë debitorë të cilët datojnë që nga viti 2011 dhe janë detyrime të krijuara po nga viti 2011 kryesisht nga ishpunonjës të Prokurorisë si dhe një debitor subjekt privat, G. auto shpk në vlerën 1,375,646 lekë . Këto detyrimeve nuk janë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pa shpresë arkëtimi, duke ndjekur të gjitha hapat dhe shkallët ligjore për arkëtimin e tyre.

Nga auditimi rezultoi se subjekti nuk i ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Nga analiza e Pasivit (Detyrimet) rezulton se te Pasivet afatshkurtra janë paraqitur në vlerën 432 112 891 lekë e cila përbëhet nga detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2018 si “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” (llog. 401-408) për 520 851 lekë “*detyrime ndaj personelit*” (llog. 421-428) për 9 523 573 lekë, “*Detyrime taksa për tu derdhur në shtet*” (llog. 431) për 1 386 077 lekë, për “*sigurime shoqërore*” (llog. 435) në vlerën 2,744 843 lekë, “*sigurime shëndetësore*” (llog. 436) në vlerën 422,891 lekë mijë.

Llog.466 “*Kreditorë dhe mjete në ruajtje*” për 412 099 331 lekë; të tjera operacione me shtetin kreditor 3 938 213 lekë, si dhe pasive të tjera llog 478. Diferenca nga konvertimi 1 477 112 lekë.

Nr.	Nr. Llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
68		PASIVET(DETYRIMET)	430,635,779	430,301,434
		I.Pasivet Afat shkurtra		
		1. Llogari te Pagushme		
69	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	520,851	47,619,500
70	42	Detyrime ndaj personelit	9,523,573	8,411,680
71	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
72	460	Huadhenes		
73	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,386,077	1,124,817
74	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
75	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
76	435	Sigurime Shoqerore	2,744,843	2,568,404
77	436	Sigurime Shendetsore	422,891	371,639
78	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
79	44	Institucione te tjera publike		
80	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
81	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
82	466	Kreditorë per mjete ne ruajtje	412,099,331	366,267,182
83	467	Kreditorë te ndryshem		
84	4341	Operacione me shtetin(detyrime	3,938,213	3,938,212

Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” (llog. 401-408) në vlerën 520,851 lekë ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, kontrolluam rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

Llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (te drejta)” zënë shumën 14,598,236 lekë e cila në pasiv në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, shumë e cila korrespondon me llogarinë 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti” në Formatin nr. 2, “Pasqyra e performancës financiare”, llogari të pagueshme, të cilat trashëgojnë në vitin 2018 si “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) për 520,851 lekë, “Detyrime ndaj personelit” (llog. 421-423) për 9,523,573 lekë, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” (llog. 431) për 1,386,077 lekë, për “sigurime shoqërore” (llog. 435) në vlerën 2,744,843 lekë, “sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vlerën 422,891 lekë. “Kreditorë për mjete në ruajtje” (llog. 466) në vlerën 412,099,331 lekë e cila përfaqëson llogari të sekuestruara nga Prokuroria.

Titulli i gjetjes 3:	Për vitet 2018-2019, mungon analiza e llog. 468 “debitorë të ndryshëm” në vlerën 3,803,861 lekë.
Situata 1:	Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, mungon analiza e llog. 468 “debitorë të ndryshëm” në vlerën 3,803,861 lekë. Konkretisht, në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet në vlerën 3,803,861 lekë, vlerë e cila nuk rezulton të jetë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pa shpresë arkëtimi.
Kriteri:	Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje lidhur me këtë zë, në regjistrat kontabël.
Rëndësia	I lartë
Rekomandime	Nga Sektori i Financës të merren masat për të analizuar llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 3,803,861 lekë, për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pa shpresë arkëtimi, duke ndjekur të gjitha hapat dhe shkallët ligjore për arkëtimin e tyre.

a. Auditimi i pasqyrave të pozicionit financiar viti 2019; nëse Pasqyra (Pasqyra nr. 1) individuale e pozicionit financiar (bilanci kontabël) pasqyron në mënyrë të klasifikuar e strukturuar aktivet, detyrimet dhe fondet neto të njësisë së qeverisjes së përgjithshme në datën e përcaktuar për mbylljen e vitit ushtrimor raportues.

Nga auditimi u konstatua se:

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Pasqyrat financiare për vitin 2019 janë hartuar dhe depozituar me shkresën nr. 652 datë 30.04.2020 brenda afatit ligjor.

Pasqyrat financiare kanë të plotësuar; pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare ose pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; pasqyrën e flukseve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. Pasqyrat financiare vjetore janë shoqëruar me



pasqyrat statistikore, si pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto dhe pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës dhe të ndryshme.

Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhurnuar, si dhe i llogarive inventariale të magazinës dhe është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Auditimi i aktiveve afatgjata:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve afatgjata; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte. Nëse aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre. Lidhur me këto aktive, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nëse kanë analizuar e rakorduar investimet e tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e ndërmarrjeve të tjera (publike ose jopublike). Për këtë qëllim, nga njësia a janë saktësuar regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar.

b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve afatgjata, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata;

U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.

U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata:

1. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:

- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostonë së tyre të prodhimit.
- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes. (UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”).

2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2018 rezultoi:

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**Në analizë aktivet:

Në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata materiale” në vlerën 451 832 mijë janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
42		II.AKTIVET AFAT GJATA		451 832 189
43	20	2. Aktivet afatgjata jo materiale		1 661 600
	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
	202	Studime kerkime		755 000
	203	Koncesione,patenta,licenca të ngjashme		906 600
47	21,23,24,28	2. Aktivet afatgjata materiale		451 170 589
48	210	Toka, troje, terrene		
49	211	Pyje, plantacione		
50	212	Ndërtesa e konstruksione		97 487 311
51	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore		783 100
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje		268 647 681
53	215	Mjete transporti		16 639 531
54	216	Rezerva shtetërore		
55	217	Kafshë pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik		66 612 966
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara		
58	28	Caktime të aktiveve afatgjata		
59	25-26	3. Aktive afatgjata financiare	0	0
60	25	Huadhënie e nënhuadhënie		
61	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		

Zëri “Ndërtime e konstruksione” (llog. 212) për vlerën 92,612,951 lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer , por duhet të theksojmë se vlera kontabël e ndërtesës kontabilizohet dhe llogaritet amortizim, por rezulton se ndërtesa dhe trojet rreth saj janë pronë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme i ka vetëm në përdorim. (trajtuar hollësisht në pasqyrat e vitit 2018)

Zëri “Rrugë, rrjete, vepra ujore” (llog. 213) për vlerën 783,100 lekë e cila nuk është e zbërthyer në mënyre analitike nga cilat objekte përbëhet dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune” (llog. 214) për vlerën 215,657, 936 lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Mjete transporti” (llog. 215) është për vlerën 13,311,625 lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Zëri “Inventar ekonomik” (llog. 218) për vlerën 26,952,398 lekë është i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer.

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata:

Në pasqyrën anekse statistikore formati 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike” kolona 2 “blerje e krijuar me pagesë” për vlerën 4 897 286 lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve afatgjata, “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 834,146 lekë, “Inventar ekonomik” në vlerën 4, 063 140 lekë,

Në kolonën 4 “shtesa pa pagesa brenda sistemit” për vlerën 2,374 948 lekë janë pasqyruar shtesat e aktiveve, në “Inventar ekonomik” në vlerën 2,374 948 lekë,

Formati 7/a, kolona 9 pakësime gjatë vitit ushtrimor “pakësime të tjera” janë pasqyruar pakësime të aktiveve, “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 42, 800 lekë si dhe “Inventar ekonomik” në vlerën 29,418,690 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Formati 7/a, kolona 7 pakësime gjatë vitit ushtrimor “Nxjerrje jashtë përdorimit” nuk ka pasqyruar pakësime të aktiveve, pavarësisht se nga inventarët e kryer evidentohen aktive për nxjerrje jashtë përdorimi, por që nuk është kryer si proces (trajtuar më hollësisht te inventarët).

-Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakoordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 20) në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” kolona 11 “Gjendja në mbyllje të ushtrimit” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), kolona 8 “Kosto historike” 1,709,000 lekë. Por kjo llogari e cila në vetvete përmbledh : (llog.201) “Prime të emisionit dhe rimbursime të huave” në vlerën 480 000 lekë;

(llog.202) studime dhe kërkime në vlerën 755 000 lekë; (llog.203) Koncesione, patenta, licenca e te tjera të ngjashme, të tre këto llogari mbarten vit mbas viti në pasqyrat financiare por nuk ka evidencë kontabël e cila të paraqesi se çfarë përfaqësojnë dhe kush i zotëron këto aktive.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” kolona 11 “Gjendja në mbyllje të ushtrimit” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kolona 8 “Kosto historike 861 511 773 lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 20) në formatin nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” kolona 10 “Teprica neto” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Ushtrimi i mbyllur” llogaria 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 1,661, 600 lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” kolona 10 “Teprica neto” është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Ushtrimi i mbyllur” llogaria 20 “Aktive afatgjata materiale”, 350 979 610 lekë.

Pasqyra krahasuese e pozicionit financiar me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata:

Në lekë

Llog.	Emërtimi	Ushtrimi paraardhës	Ushtrimi mbyllur	Formati 7/b, (Gjendja dhe ndryshimet)	Diferenca (4-5)
1	2	3	4	5	6
201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave	480,000	480,000		
202	Studime dhe kërkime	755,000	755,000		
203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme	474,000	474,000		
210	Toka, Troje, Terrene	0			
211	Pyje, Plantacione	0	0		
212	Ndërtesa e Konstruksione	157,608,203	157,608,203		
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	783,100	783,100		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	446,733,981	447,525,327	834 146	
215	Mjete Transporti	59,246,422	59,246,422		
216	Rezerva Shtetërore	0	0		
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0		
218	Inventar ekonomik	219,329,323	196,348,721	29 418 690	
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0			
28	Caktime të Aktiveve Afatgjata	0			
	TOTALI	451 832 189	350 979 610	29 461 490	

Baza e llogaritjes vjetore të amortizimit për aktivet afatgjata mbi të cilat është aplikuar përqindja përkatëse e amortizimit vjetor mbi bazë grupimi (Pasqyra anekse statistikore Formatit 7/b) është e barabartë me:

- Vlerën kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore; (vlera 885,410 029 lekë). Amortizimi i akumuluar 512 241 169 lekë.



- Shtesën e kostos së blerjes dhe kostos së përmirësimit dhe rinovimit të kategorive përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore; (vlera 7 272 234 lekë). Amortizimi i llogaritur 78,663 329 lekë, si dhe

- Zbritjen e vlerës kontabël neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit apo të humbura për kategorinë përkatëse të aktiveve gjatë periudhës ushtrimore (vlera 29 461 490 lekë). Amortizimi i llogaritur 0 lekë.

Amortizimi i vitit 2019 është 512 241 169 lekë.

Amortizimi i aktiveve afatgjata është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

36. Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacionin fiskal përkatës, si më poshtë vijon:

- Për aktivet afatgjata, materiale si: ndërtesat, konstruksionet, linjat teknologjike e të prodhimit dhe makineritë e pajisjet me afat të gjatë shërbimi, duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;

- Kompjuterët, pajisjet e ruajtjes së të dhënave, softet e sisteme informacioni të amortizohen mbi bazë grupimi me normën 25%;

- Për të gjitha aktivet e tjera afatgjata materiale duhet të zbatohet norma vjetore e amortizimit 20% mbi bazë grupimi; dhe

- Për aktivet afatgjata jomateriale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%.

Nga auditimi i kartelës së llogarisë 209 “Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale”; dhe 219 “Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale”, (formati nr. 1) dhe pasqyrës statistikore formati 7, “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë:

Llog. nr. 202 “Amortizim, studime dhe kërkime” = -47 400 lekë.

Llog. nr. 212 “Amortizim ndërtim dhe konstruksione” = 64 995 258 lekë.

Llog. nr. 213 “Amortizim Rruge, Ura, Rrjete, Rezervuare” = 0 lekë,

Llog. nr. 214 “Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” = 231 867 391 lekë,

Llog. nr. 215 “Amortizim Mjete transporti” = (45,934,797) lekë,

Llog. nr. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” = (169,396,323) lekë.

Në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera bruto e studimeve dhe projekteve, përkatësisht prej 755 000 lekë. Për Llog. nr. 213 “Amortizim Rruge, Ura, Rrjete, Rezervuare” = 0 lekë, Për këto vlera nga ana e Sektorit të Financës nuk janë kryer llogaritjet e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara që nga marrjen e këtyre shumave në llogarinë e aktiveve duke e evidentuar vit pas viti në po të njëjtën vlerë.

Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e paragrafit nr. 107, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale”, i përmirësuar, ku përcaktohet se:

“Amortizimi është konstatimi kontabël i pakësimit të vlerës së një elementi të aktiveve të qëndrueshme që rezulton nga përdorimi, nga koha, nga ndryshimet teknike dhe nga çdo shkak tjetër, efektet e të cilëve janë të pakthyeshme (përfundimtare) për shkak të vështirësive të matjes së zhvlerësimit amortizimi konsiston, përgjithësisht, në shpërndarjen e vlerës së elementeve normalisht të amortizueshëm mbi të gjithë kohën e parashikuar të shërbimit të tyre.

Paragrafit nr.107: “Shpenzimet e amortizimit të AAM-ve dhe AAJM-ve, si dhe humbjet nga zhvlerësimi, paraqiten si zë më vete i formatit 1 të pasqyrës së performancës, si dhe në zërat përkatës të formatit 2, në varësi të funksioneve të aktiveve në njësinë ekonomike. Fitimet/humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të AAM dhe AAJM njihen në zërat “Shpenzime të tjera të shfrytëzimit”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Paragrafit nr.110: “Një njësi ekonomike duhet të japë për AAJM informacionin e mëposhtëm shpjegues:

(a) Një përshkrim të vlerës kontabël neto dhe periudhës së amortizimit të çdo aktivi jomaterial që konsiderohet material për pasqyrat financiare të njësisë;

(b) Për aktivet jomateriale të përfuara nëpërmjet një granti të qeverisë dhe të njohur fillimisht me vlerën e drejtë:

(i) Vlerën e drejtë të njohur fillimisht për këto aktive; dhe

(ii) Vlerat kontabël neto të tyre.

Nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e Kapitulli III, Seksionit II, “Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara”, të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e Standardeve dhe rregullave kontabël”, ku në lidhje me regjistrimet kontabël për aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara përcaktohet se: “Ligji për “Për kontabilitetin “parashikon një kufizim të afatit për amortizimin e këtyre aktiveve (deri në 5 vjet) nisur nga rreziqet që mund t’i vijnë kreditorëve të njësisë ekonomike në rast të një falimentimi, sepse disa elemente janë të pashitshme (p.sh. shpenzimet e nisjes e të zgjerimit ¹), ose bëhen të pashitshme apo të pavlershme (p.sh. fondi tregtar). Megjithatë për elemente që gëzojnë një mbrojtje ligjore ose janë të lidhura me një element tjetër të trupëzuar amortizimi mund të bëhet në një afat më të gjatë”.

Aktivitet afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues, llog. 31, zëri “Materiale” në shumën prej 17,027,287 lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

Aktivitet afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues llog. 32, zëri “Inventari i imët” në shumën prej 1 541 712 lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël.

Në aktivin e bilancit kontabël “Llogari të arkëtueshme” pasqyrohen në bilanc Formati nr. 1 për vlerën 23 452 106 lekë detyrime ku:

- “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” (llog. 423,429) zënë shumën 221 111 lekë,

- “Debitorë të ndryshëm” (llog. 468) në vlerën 3,803,861 mijë lekë përbëhen në analizë nga 26 persona debitorë për detyrimin në vlerën 2, 428, 215 lekë debitorë të cilët datojnë që nga viti 2011 dhe janë detyrime të krijuara po nga viti 2011 kryesisht nga ishpunonjës të Prokurorisë si dhe një debitor subjekt privat, G.auto shpk në vlerën 1,375,646 lekë . Këto detyrimeve nuk janë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pa shpresë arkëtimi, duke ndjekur të gjitha hapat dhe shkallët ligjore për arkëtimin e tyre.

Si dhe llog 4342 “operacione me shtetin” të drejta në shumën 19, 427,134 lekë.

Nga auditimi rezultoi se subjekti nuk i ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

Nga analiza e Pasivit (Detyrimet) rezulton se te Pasivet afatshkurtra janë paraqitur në vlerën 795 631 334 lekë e cila përbëhet nga llogari të pagueshme: 794 154 222 lekë si dhe detyrimet afatshkurtra të cilat trashëgohen në vitin 2018 si “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) për 2 970 132 lekë “ detyrime ndaj personelit” (llog. 421-428) për 11 043 086 lekë, “Detyrime taksa për tu derdhur në shtet” (llog. 431) për 1 934 335 lekë, për “sigurime shoqërore” (llog. 435) në vlerën 2,986 261 lekë, “sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vlerën 493,320 lekë.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Llog.466 “Kreditorë dhe mjete në ruajtje” për 770 702 116 lekë; të tjera operacione me shtetin detyrime 4 024 972 lekë, si dhe pasive të tjera llog 478. Diferenca nga konvertimi 1 477 112 leke.

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
68		PASIVET(DETYRIMET) I.Pasivet Afat shkurtër 1. Llogari të Pagushme	795,631,334 795,631,334 794,154,222	432,112,891 432,112,891 430,635,779
69	401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	2,970,132	520,851
70	42	Detyrime ndaj personelit	11,043,086	9,523,573
71	16,17,18	Hua Afat shkurtër		
72	460	Huadhenes		
73	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,934,335	1,386,077
74	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
75	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
76	435	Sigurime Shoqërore	2,986,261	2,744,843
77	436	Sigurime Shëndetsore	493,320	422,891
78	437,438,	Organizma të tjera shtetërore		
79	44	Institucione të tjera publike		
80	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
81	464	Det.për tu paguar për bl.letrave me vlerë		
82	466	Kreditorë për mjete në ruajtje	770,702,116	412,099,331
83	467	Kreditorë të ndryshëm		
84	4341	Operacione me shtetin(detyrime	4,024,972	3,983,213

Shqyrtimi i llogarive të debitorëve “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) në vlerën 2,970,132 lekë ka të bëjë në thelb me kontrollin e origjinës dhe të natyrës së tyre: për këtë qëllim, kontrolluam rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepërcave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohemi se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohemi nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

Llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (te drejta)” zënë shumën 19,427,134 lekë e cila në pasiv në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, shumë e cila korrespondon me llogarinë 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti” në Formatin nr. 2, “Pasqyra e performancës financiare”, llogari të pagueshme, të cilat trashëgojnë në vitin 2018 si “Furnitorë e llogari të lidhura me to” (llog. 401-408) për 2970 132 lekë, “Detyrime ndaj personelit” (llog. 421-423) për 11 043 086 lekë, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” (llog. 431) për 1 934 335 lekë, për “sigurime shoqërore” (llog. 435) në vlerën 2 986 261 lekë, “sigurime shëndetësore” (llog. 436) në vlerën 493 320 lekë. “Kreditorë për mjete në ruajtje” (llog 466) në vlerën 770 702 116 lekë e cila përfaqëson llogari të sekuestruara nga Prokuroria.

-Inventarizimi i pronës shtetërore, për vitet 2018-2019. Nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël.

Në bazë të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm Nr.118 datë 08.11.2018 “Mbi inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e tyre në Prokurorinë e Përgjithshme” për vitin 2018, komisioni i përbërë nga E.Z, kryetar, E.K, A.P, Sh.B, M.Q anëtarë, kreu inventarizimin e vlerave materiale të Prokurorisë së Përgjithshme, nga data 15.11.2018 deri më 25.12.2018.

Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, Nr 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr 20, datë 24.11.2014 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Gjatë inventarizimit të vlerave materiale fizike të krahasuara me vlerat kontabile që ka Sektori i Financës, Kontabilitetit dhe Investimeve rezultoi si më poshtë:

Objektet e inventarizuara	Vlerat kontabël	Vlerat fizike	Diferenca
1. Aktive Afatgjata Materiale	852,262,345.79 lekë	852,262,345.79 lekë	-
2. Materiale	23,025,319.85 lekë	23,025,319.85 lekë	-
3. Inventari i imët	1,414,972.10 lekë	1,414,972.10 lekë	-
Shuma:	876,702,637.74		

Gjatë kryerjes së inventarizimit fizik, janë konstatuar se shumë artikuj janë jashtë funksionit për shkak të dëmtimeve të ndryshme si thyerje, skadim, etj. Këta artikuj janë të përdorur për disa vite, duke humbur vlerën e përdorimit të mëtejshëm.

Numri i këtyre artikujve të dëmtuar është **88** dhe vlera monetare e tyre është **7,365,350.88** lekë. Për sa më sipër Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve në Prokurorinë e Përgjithshme, ka propozuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe shkarkimin e tyre sipas vlerave përkatëse nga kartelat e magazinës dhe të financës, por që rezultoi të mos jetë kryer.

Në bazë të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm Nr.132 datë 25.11.2019 “Mbi inventarizimin e aktiveve dhe vlerësimin e tyre në Prokurorinë e Përgjithshme” për vitin 2019, komisioni i përbërë nga E.Z, kryetar, S.H, A.H, Sh.B, A.Q anëtarë, kreu inventarizimin e vlerave materiale të Prokurorisë së Përgjithshme, nga data 25.11.2019 deri më 25.12.2019. Bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, Nr 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar me Udhëzimin, Nr 20, datë 24.11.2014 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, gjatë procesit të inventarizimit ka ndjekur procedurat e përpilimit të një proces- verbal për fiksimin e numrit rendor të fletë – hyrjeve dhe fletë – daljeve të magazinës si dhe u bë mbyllja dhe dyllosja e magazinës. ka kryer verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit të institucionit dhe të magazinës. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, ka krahasuar gjendjen konkrete e aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit, gjatë të cilit ka rezultuar pa diferenca.

Gjatë inventarizimit të vlerave materiale fizike të vitit 2019 të krahasuara me vlerat kontabile që ka Sektori i Financës, Kontabilitetit dhe Investimeve rezultoi si më poshtë:

Objektet e inventarizuara	Vlerat kontabël	Vlerat fizike	Diferencat
1. Aktive Afatgjata Materiale	857,096,190.00 lekë	857,209,350.00 lekë	113,160
2. Materiale	20,093,983.68 lekë	20,093,983.68 lekë	-
3. Inventari i imët	1,425,972.10 lekë	1,425,972.10 lekë	-
Shuma e vlerës fizike:	878,799,305.8		

Gjatë kryerjes së inventarizimit fizik, komisioni i inventarizimit ka konstatuar se shumë artikuj janë jashtë funksionit për shkak të dëmtimeve të ndryshme si thyerje, skadim, etj. Këta artikuj janë të përdorur për disa vite, duke humbur vlerën e përdorimit të mëtejshëm, dhe ka evidentuar se numri i këtyre artikujve të dëmtuar është **117** dhe vlera monetare e tyre është **10,855,313** (dhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e trembëdhjetë) lekë. Për të cilët Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve në Prokurorinë e Përgjithshme ka propozuar, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe shkarkimin e tyre sipas vlerave përkatëse nga kartelat e magazinës dhe të financës.

Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve në Prokurorinë e Përgjithshme propozon, të bëhet hyrje në magazinë dhe të shkojë në dobi të Institucionit, sipas Procesverbalit datë 02.12.2019.

Nga komisioni i inventarizimit të aktiveve për vitet 2018- 2019 është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe



ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme. Në këtë raport janë pasqyruar shtesat e konstatuara për vlerën 1 artikulli dhe vlera monetare e tij është 113,160 lekë.

Nga PP për vitin 2018 janë inventarizuar e kontrolluar për ekzistencën dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktivet afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës si përcakton UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ku Inventarizimi i aktiveve: neni 73. saktëson se: Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike.

74. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë te paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

75. Titullari i njësisë publike, kur ka dyshime për mashtrime, abuzime, keqpërdorime, vjedhje apo grabitje të aktiveve apo të një pjese të tyre, ose qofte edhe për të vërtetuar saktësinë e veprimeve ligjore për një periudhë kohore, mund të urdhërojnë kryerjen e inventarizimeve të plota ose të pjesshme të tyre, pa kufizim në numër, jashtë afateve të parapara të inventarizimit të aktiveve.

Nga ana e komisionit të ngarkuara me kryerjen e inventarizimit fizik janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, për vitin 2018 Numri i këtyre artikujve të dëmtuar është 88 dhe vlera monetare e tyre është 7,365,350.88 lekë, por nga ana e kësaj njësie shpenzuese nëpërmjet nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues nuk janë ndjekur hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit dhe të vepronin konform UMF nr. 30, datë 27/12/2011, si për: *procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; procesin verbal të vlerësimit; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme*, duke marrë si reference paragrafin 95 e vazhdim, të Udhëzimit të Ministrit të Financave. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, pasi *nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit mbi informacionet e grupeve të inventarizimit*, veprime këto në kundërshtim me paragrafin nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

Për vitin 2019 numri i këtyre artikujve të dëmtuar është 117 dhe vlera monetare e tyre është 10,855,313 lekë. Për të cilët Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve në Prokurorinë e Përgjithshme ka propozuar, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe shkarkimin e tyre sipas vlerave përkatëse nga kartelat e magazinës dhe të financës.

Ky proces ka përfunduar me zbatimin e urdhrit 48 datë 27.02.2020 “Mbi asgjësimin e aktiveve të vlerësuar jashtë përdorimit në Prokurorinë e Përgjithshme” ku bazuar në rezualtatin e inventarizimit vjetor të pasurisë së institucionit për vitin 2019 me këtë urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm është kryer asgjësimi i 115 artikujve në vlerën 9,44,910 lekë në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Titulli i gjetjes
: 4**

Për vitin 2018 procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara dhe nuk janë ndjekur nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Situata1:	Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018 nuk janë finalizuar procedurat e inventarizimit, duke mos u pasuar më tej nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit, për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, sa më sipër e përfunduar vetëm në vitin 2020. Nga ana e komisionit të ngarkuar me kryerjen e inventarizimit fizik, janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, konkretisht, për vitin 2018 numri i këtyre artikujve të dëmtuar është 88 dhe vlera monetare e tyre është 7,365,350.88 lekë, për të cilat nuk është marrë asnjë masë e mëtejshme sikundër udhëzon kuadri ligjor në fuqi. Rezultoi se, nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit, mbi informacionet/relacionet e grupeve të inventarizimit, duke mos u finalizuar procesi si dhe duke rrezikuar që të mos merret siguri për vlerën e këtij zëri, sikundër pasqyrohet në Pasqyrat financiare
Kriteri:	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje lidhur me këtë zë, në regjistrat kontabël.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandime	Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, të ndjekin hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; proces verbalin e vlerësimit; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme.

Administrimi i karburantit

U konstatua se, gjatë periudhës objekt auditimi (2018, 2019 dhe 8 mujorin 2020), janë kryer shpenzime dhe janë bërë dalje 62 865 litra karburant për automjetet, me vlerë 9 368 708 lekë, e ndarë në periudha si vijon:

- në sasinë 31 274 litra, me vlerën 5 387 994 lekë për vitin 2018,
- në sasinë 22782 litra, me vlerën 3 810 277 lekë për vitin 2019,
- në sasinë 8809 litra, me vlerën 170 437 lekë për 8 –mujorin e vitit 2020,

Për automjetet në funksion të Prokurorisë së Përgjithshme është mbajtur dokumentacioni justifikues mbi kryerjen e shërbimit dhe të realizimin efektivisht të këtyre shpenzimeve, dokumentacion që është nënshkruar rregullisht nga zyrtarët apo punonjësit udhëtues. Në çdo rast tërheqja e sasisë së karburantit është realizuar me autorizim. Megjithatë, janë vërejtur mangësi e parregullsi, pasi në disa raste të dhënat mbi kilometrat apo sasi të karburantit të regjistruara në fletët e udhëtimit janë me korrigjime, në disa raste janë konsideruar lëvizje të brendshme pa specifikuar destinacionin dhe duke mos pasqyruar saktë masën e konsumit të karburantit të automjeteve, është shënuar vetëm destinacioni i nisjes ose kthimit, regjistruar destinacione që nuk janë të lexueshme, janë të pakuptueshme, etj, vepruar jo në përputhje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe paragrafin nr. 36, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30/2011, ku përcaktohet se: “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të



nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”: si dhe pikën nr. 6, kreu II, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, që shpreh se: “Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë dokumentare gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes” dhe paragrafin nr. 36 kreu III, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30/2011: “Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktuesin e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative¹². Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve. “

Nuk evidentohet për periudhën objekt auditimi inventarizimi i gjendjes së sasive të karburantit në çdo fund viti apo në çdo proces të inventarizimit të kryer, në shkelje të kërkesave të pikës 74, kreu IV, të UMF nr. 30/ 2011, sipas të cilit, “*çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

b. Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve; do të përfshijë verifikimin e të gjitha llogarive në aspektin e pohimeve të auditimit. Nëse totali i të ardhurave është i barabartë me shumën e totalit të të ardhurave nga taksat dhe tatimet, totalit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të të ardhurave jo-tatimore, totalit të të ardhurave financiare, totalit të granteve korrente, totali të të ardhurave të tjera, si dhe ndryshimit të gjendjes së inventarit të produkteve.

Nëse totali i shpenzimeve është i barabartë me shumën e totalit të shpenzimeve për pagat dhe përfitimet e punonjësve, totalit të shpenzimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të shpenzimeve për blerje të mallrave dhe shërbimeve, totalit të shpenzimeve për subvencione, totalit të shpenzimeve për transferime korrente, totalit të shpenzimeve financiare, totalit të shpenzimeve për kuota amortizimi dhe shuma të parashikuara, totalit të shpenzimeve që rrjedhin nga ndryshimi i gjendjes së inventarit, si dhe totalit të shpenzimeve të tjera; nëse pasqyra e performancës financiare përfaqëson tepëricën apo deficitin e periudhës (rezultatit e veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur).

Analiza e shpenzimeve dhe të ardhurave të ushtrimit: Viti 2018

Kjo pasqyrë financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transfertat dhe operacionet që lidhen me rezultatit financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm.

Në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit, në të cilat përfshihen shpenzimet për pagat dhe përfitimet e punonjësve, shpenzimet për kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të shpenzimeve për transfertat për buxhetet familjare, totalit të shpenzimeve për blerje të mallrave dhe shërbimeve, të shpenzimeve për transferime korrente, të shpenzimeve financiare, shpenzimet që rrjedhin nga ndryshimi i gjendjes së inventarit si dhe shpenzimeve të tjera.


Gjatë vitit 2018 shpenzimet janë në ulje në krahasim me vitin e mëparshëm për **25,687,501** lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

SHPENZIMET



Formati Nr. 2 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 2,638,691 lekë të ndara sipas zërave si (600) “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 131,216,890 lekë ose 56 % të totalit të shpenzimeve korrente (prej 233,819,564 lekë), ku janë paraqitur shpenzimet për pagat e personelit të përhershëm në vlerën 131,216,890 lekë dhe shpërblime të tjera personelit 0 lekë të PP, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2018.

Llog. (601) “Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore” në vlerën 18,157,744 lekë ose 7.8 % të totalit të shpenzimeve, llog. (602) “Mallra dhe shërbime të tjera” në vlerën 80,891,274 lekë ose 35 % të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2018.

Llog. (606) “Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 831,761 lekë, ose 0.4% të totalit të shpenzimeve përfaqëson shumën e ndihmes ekonomike për rast fatkesësie për 120,000 lekë, ndihmë ekonomike prej 150,000 lekë si dhe pagesë “Page Kalimtare” referuar pikë 13, shkornja “c” të VKM-së nr.548, datë 27.07.2016 “Për miratimin e rregullove dhe procedurave për përfitimin e pensioneve Shtetërore suplementare.

Per vitin 2018

Nr.	Shkresa e MSH	Numri i shkresës	Data	Shuma bruto	Tatim ne bruim	Shuma neto
1	Akordim fondi veçantë					
	Ndihme ekonomike rast fatkeqesie	279	21.12.2017	30,000		30,000
	Ndihme ekonomike rast fatkeqesie	264	07.12.2018	30,000		30,000
2	Akordim fondi i veçantë					
	Ndihme ekonomike rast semundje	22	16.01.2018	50,000		50,000
	Ndihme ekonomike rast semundje	109	06.04.2018	50,000		50,000
3	Akordim fondi i veçantë					
	Ndihmë ekonomike pension pleqërie	159	11.06.2018	42,625		42,625
4	Pages Kalimtare					
	Prokuror	281	07.10.2019	629,136	94,370	534,766
	Totali (606) 2018			831,761		574,266

Llog. (63) “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 2,638,691 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Llo gari a	Përshkrimi b	Sipas formatit nr. 4 të bilancit vjetor c	Sipas të dhënave të akt rakordimit vjetor me degën e thesarit ç	Grante të brendshme kapitale në natyrë d	Total grantet e brendshme kapitale (ç+d) e	Diferenca (e-c) f
a	b	c	ç	d	e	f
105/ 231	Grantet e brendshme kapitale	84,674,131	80,836,378	4,349,161	85,185,539	511,408

Burimi: Drejtoria e Financë, Përpunuar nga audituesi.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se në bilancin kontabël (formati 4), në llogarinë ekonomike 105 “Grantet e brendshme kapitale” është paraqitur vlera 84,674,131 lekë. Në të dhënat e tabelës së akt rakordimit të shpenzimeve me thesarin për 12 mujorin, paraqitet vlera 80,836,378 lekë. Në (llog.1059) “Grante të brendshme kapitale në natyrë” jepet vlera 4,349,161 lekë. Shuma e të dhënave të akt rakordimit të thesarit për 12 mujorin me grante të brendshme kapitale në natyrë është 85,185,539 lekë. Kjo vlerë nuk rakordon me vlerën e granteve të brendshme kapitale, por ka një diferencë me 511,408 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar. Në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 9, pika 1. Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së njësive ekonomike.

Pasqyra financiare e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (Formati 4)

Viti 2019

Në Lekë

Nr. Rreshti	Referenc e	E M Ë R T I M I	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Rezerv a	Fonde te tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Tepriç/Defici t	Rezultatet e Ushtrimit Tepriç/Defici t	GJITHSE J Aktive/net o Fonde/ Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6
1	101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	480,185,709					480,185,709
2		II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	0	0	- 111,134,212	0	0	- 111,134,212
3		1.NGA BURIME TE BRENDSHME	0	0	-- 111,134,212	0	0	-- 111,134,212
4	105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	0		4,897,286			4,897,286

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

5	1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0		2,374,948			2,374,948
6	1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)	0		- 29,461,490			- 29,461,490
7	12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)			-8.094			-8.094
8	85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	0		- 10,273,533			- 10,273,533
9	111	Nga Rezervat (+,-)	0					0
10	115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	0					0
11	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)	0					0
13	1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	0		- 78,663,329			- 78,663,329
14	1015	Nga nxjerrjet jashtepedorimit dhe demtimet(-)	0					0
15	107	Vlera te AAGJ, te Caktuara ne perdorim(+,-)	0					0
16	109	Diferenca nga Rivleresimi I AAGJ(+,-)	0					0
17		2.NGA BURIME TE JASHTME	0	0	0	0	0	0
18	106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)	0					0
19	1016, 1069	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0					0
20		TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	480,185,709	0	- 111,134,212	0	0	369,051,497

Pasqyra financiare e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të aparatit të Prokurorisë së Përgjithshme gjatë vitit ushtrimor raportues.

Rubrika e I “Aktivet neto/fondet neto”, vlera 480,185,709 lekë pasqyron shumat përkatëse për gjendjen e fondeve/aktiveve neto në fillim të periudhës ushtrimore, për çdo zë si: ndryshimet në aktivet/fondet neto, që rrjedhin nga burime të brendshme (nga grantet e brendshme kapitale, transfertat e brendshme të AAGJ-së, dhurata në natyrë, nga shitjet e AAGJ-së, nga rezultatet e mbartura, nga rezervat e të tjerë), si dhe nga burime të jashtme (nga grantet e jashtme kapitale dhe transfertat e brendshme të AAGJ-së, dhurata në natyrë). Çelja e vitit ushtrimor në zërin “Fonde bazë” (llog.101) në vlerën 480,185,709 lekë kuadron në pasiv të pasqyrës financiare (formati 1), me ushtrimin paraardhës.

Në zërin “Grantet e brendshme kapitale” (llog.105) janë paraqitur grante kapitale nga buxheti i shtetit në vlerën 4,897,286 lekë, të cilat janë përdorur nga institucioni për shpenzimet e aktiveve afatgjata materiale.

Në zërin “Transfertat e brendshme të AAGJ, dhurata në natyrë”(llog.1059), janë paraqitur aktive të dhuruara nga transferime të brendshme në vlerën 2,374,948 lekë.

Në zërin “Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ-së” (llog.1013) është paraqitur amortizimi vjetor i aktiveve afatgjata, në vlerën (78,663,329) lekë, i cili kreditohet me (llog. 209 e 219) “Amortizimi i aktiveve afatgjata”.

Në fund të pasqyrës është pasqyruar Totali i fondeve të veta në vlerën 369,051,497 lekë. Kjo vlerë është e barabartë me totalin e aktiveve/fondet neto të evidentuar në pasiv të pasqyrës financiare (formati 1, rubrika C).

Titulli i Gjetjes 6 | Mosrakordim vlere në Pasqyrën financiare në aktivet neto/fondet

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

	neto, për vitin 2018. (Formati 4)
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, në llogarinë ekonomike 105 “Grantet e brendshme kapitale” të formatit 4 të pasqyrave financiare, është paraqitur vlera 84,674,131 lekë, që është përdorur nga institucioni për shpenzimet e aktiveve afatgjata materiale (llog.231). Në të dhënat e tabelës së akt rakordimit të shpenzimeve me thesarin, për 12 mujorin e viti 2018, paraqitet vlera 80,836,378 lekë dhe në (llog.1059) “Grante të brendshme kapitale në natyrë” jepet vlera 4,349,161 lekë nga ku totali për të dyja llogaritë rezulton 85,185,539 lekë. Kjo vlerë nuk rakordon me vlerën e granteve të brendshme kapitale, me të cilën krijon një diferencë prej 511,408 lekë, e mbartur kjo edhe në pasqyrat financiare të vitin 2020.
Kriteri :	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare duhet të sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse për sistemimin dhe saktësimin e vlerës në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2020.

Shënimet dhe relacioni për llogaritë.

Procedurat e auditimit për “Shënimet e llogarive” do të synojnë që të verifikojnë nëse prezantimi dhe pohimet e komentuara për çdo seksion të pasqyrave financiare kryhen komente tek seksioni “Shënimet” përfshi dhe llogaritë jashtë bilancit.

Për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare audituesi të arrijë në përfundimin se është arritur siguria e arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Ky përfundim merr në konsideratë vlerësimin e audituesit për anomali të pakorrigjuara në pasqyrat financiare, nëse ka të tilla.

Një anomali shfaqet si një diferencë midis shumë, klasifikimit, paraqitjes, ose informacionit shpjegues të dhënë për një element ose një shumë të pasqyrës financiare të raportuar dhe shumë, klasifikimit, paraqitjes apo informacionit shpjegues të dhënë që kërkohet të jetë për elementin për të qenë në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Pyetëtori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika që mbulon elemente të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në informacionin shpjegues për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të viteve 2018 dhe 2019, për Aparatin e Prokurorisë së Përgjithshme, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive po ose jo, ashtu edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Kreu III, pika 3.7. Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale.

Titulli i Gjetjes 7	Mosdhënia e informacionit të plotë në pyetësin me shënime shpjeguese për vitet 2018 - 2019 (Formati 5)
----------------------------	---

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Situata:	Nga auditimi rezultoi se, pyetëtori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në informacionin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2018 dhe 2019, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive “po” ose “jo”, ashtu edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse.
Kriteri :	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar. Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
Ndikimi/Efekti	Mosrespektimi i standardeve kontabël.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetëtori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Udhëtimet – Dietat

Nga auditimi i veprimeve me arkën për vitin 2018 - 2019 dieta jashtë shtetit, u konstatua se, në urdhrat e titullarit të institucionit janë përfshirë në grupet e punës, gjatë vizitave jashtë shtetit të titullarit të institucionit dhe oficerë të Gardës së Republikës së Shqipërisë. Pagesat e shpenzimeve për këto udhëtime si dieta ditore, sistemimi në hotel, biletat e avionit, janë likuiduar nga buxheti (shpenzime operative) i Prokurorisë së Përgjithshme. Në kundërshtim me ligjin nr. 97 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregulloren e brendshme nr. 235 datë 02.11.2018 të saj. Për rrjedhojë kostoja me efekt financiar në buxhetin e institucionit është në vlerën 4,585.16 Euro.

Të detajuara për vitin 2018:

1. Zagreb, Kroaci; urdhri nr.40 datë 08.05.2018
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH- 67.55 euro
2. Podgoricë, Mal i Zi; urdhri nr.61 datë 06.06.2018
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH- 70 euro
3. Paris, Francë; urdhri nr.44 datë 10.05.2018
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH 520.56 euro
4. Lisbonë, Portugali; urdhri nr.85 datë 11.09.2018
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH- 173.25 euro
5. Athinë, Greqi; urdhri nr.106/2 datë 09.11.2018
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH- 1,184 euro
6. Francë, urdhri nr.117 datë 09.11.2018
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH 122.5 euro

Të detajuara për viti 2019:

1. Tallin, Estoni; urdhri nr.40 datë 12.04.2019
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH- 355 euro
2. Budva, Mali i Zi; urdhri nr.70 datë 12.06.2019
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH- 1,824.2 euro



3. Izmir, Turqi; urdhri nr.100 datë 16.09.2019
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH- 52.5 euro
4. Dresden, Gjermani; urdhri nr.115 datë 21.10.2019
shpenzimi për oficerë të Gardës së RSH- 215.6 euro

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Mbyllja e bilancit për vitin 2018-2019 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe plotësimi i tij është bërë në formatin elektronik (programi financa 5), duke rakorduar llogaritë dhe shumat përkatëse, veprimet janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur.

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pamodifikuar me theksim të çështjes)

Ne audituam pasqyrat financiare të Prokurorisë së Përgjithshme (Aparati), më datë 31.12.2018 dhe 31.12.2019 të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes”.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pamodifikuar të auditimit me theksim të çështjes**⁴.

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Prokuroria e Përgjithshme, sa i takon:

⁴ **OPINIONI I PAMODIFIKUAR me theksim të çështjes:** Një opinion i pamodifikuar me theksim çështje jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5)



- evidentimit të plotë dhe të saktë në pasqyrat financiare të vitit 2020, të llogarisë “Toka troje terren”, e cila është kontabilizuar në mënyrë të padrejtë në vlerën 0 lekë, me qëllim saktësimin e vlerës së këtij zëri kontabël dhe rritjen e besueshmërisë së pasqyrave financiare.
- evidentimit me evidenca kontabël të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale, konkretisht llogaria 213 “Studime dhe kërkime”, “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 783,100 lekë, me qëllim detajimin e këtij zëri për të rritur saktësinë dhe plotësinë e të dhënave.
- analizimit të llogarisë 468 “Debitore të ndryshëm”, për të evidentuar klasifikimin e atyre debitorëve që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre pa shpresë arkëtimi, me qëllim ndjekjen e të gjitha hapave dhe shkallëve ligjore për arkëtimin e tyre.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Prokurorisë së Përgjithshme është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objekti ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Prokurorisë së Përgjithshme me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Në përfundim të auditimit rezultuan gjetje me rekomandimet përkatëse si më poshtë vijon:

B.MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës-truall në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, më konkretisht në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, “Aktivet afatgjata materiale”, llogaria 213 “Toka troje terren” është pasqyruar në mënyrë jo të saktë, në vlerën 0 lekë, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Grupi i auditimit konkludoi se, referuar çmimeve të publikuara,⁵ vlera e pasurisë së paluajtshme të llojit tokë-truall, për qytetin e Tiranës, për zonën kadastrale nr. 8150, përcaktohet me një çmim prej 66,969 lekë/m², nga ku për sipërfaqen prej 2409,4 m² që ka prona në fjalë, rezulton një

⁵ <https://geoportal.asig.gov.al/sq/dhenat>



vlerësim prej 161,355,109 lekë. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/a faqen 13 të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale “Toka troje terren”, në administrim të institucionit Prokuroria e Përgjithshme.

Nga Sektori i Financës të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, evidentohet mungesa e evidencave kontabël të sakta, lidhur me vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Jo Materiale; “Studime dhe kërkime”. Konkretisht për llogaritë 202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 755 000 lekë, dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 783 100 lekë, si pasojë e mungesës së evidencave kontabël, nuk arritëm të sigurojmë informacion mbi llojin dhe natyrën e zërave që janë përfshirë në llogaritë respektive, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, duke vendosur institucionin përpara riskut që Pasqyrat financiare të mos sigurojnë të dhëna të plota dhe të nevojshme për vendimmarrjen, lidhur me këto zëra. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/a) faqe 14 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat për të saktësuar me evidenca kontabël, llojin dhe natyrën e aktiveve afatgjata jomateriale/materiale në llogaritë përkatëse 202 “Studime dhe kërkime” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të tyre.

Në vijim, Sektori i Financës të marr masa për të kryer llogaritjet e amortizimit të këtyre aktiveve, me qëllim saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitet 2018-2019, mungon analiza e llog. 468 “debitore të ndryshëm” në vlerën 3,803,861 lekë. Konkretisht, në formatin nr. 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet në vlerën 3,803,861 lekë, vlerë e cila nuk rezulton të jetë marrë në analizë për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pa shpresë arkëtimi, në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/a faqen 19 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat për të analizuar llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 3,803,861 lekë, për të evidentuar klasifikimin e atyre që kanë shpresë arkëtimi dhe atyre debitorëve pa shpresë arkëtimi, duke ndjekur të gjitha hapat dhe shkallët ligjore për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018 nuk janë finalizuar procedurat e inventarizimit, duke mos u pasuar më tej nga proceset e vlerësimit, të daljes jashtë përdorimit, si dhe asgjësimit, për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër, në kundërshtim kjo me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, sa më sipër e përfunduar vetëm në vitin 2020. Nga ana e komisionit të ngarkuar me kryerjen e inventarizimit fizik, janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë



jashtë funksionit, konkretisht, për vitin 2018 numri i këtyre artikujve të dëmtuar është 88 dhe vlera monetare e tyre është 7,365,350.88 lekë, për të cilat nuk është marrë asnjë masë e mëtijshme sikundër udhëzon kuadri ligjor në fuqi. Rezultoi se, nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit, mbi informacionet/relacionet e grupeve të inventarizimit, duke mos u finalizuar procesi si dhe duke rrezikuar që të mos merret siguri për vlerën e këtij zëri, sikundër pasqyrohet në Pasqyrat financiare. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/a faqen 28 të Raportit të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, të ndjekin hapat e mëtijshëm bazuar në konkluzionet e grupeve të inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; proces verbalin e vlerësimit; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në llogarinë ekonomike 105 “Grantet e brendshme kapitale” të formatit 4 të pasqyrave financiare, është paraqitur vlera 84,674,131 lekë, që është përdorur nga institucioni për shpenzimet e aktiveve afatgjata materiale (llog.231). Në të dhënat e tabelës së akt rakordimit të shpenzimeve me thesarin, për 12 mujorin e viti 2018, paraqitet vlera 80,836,378 lekë dhe në (llog.1059) “Grante të brendshme kapitale në natyrë” jepet vlera 4,349,161 lekë nga ku totali për të dyja llogaritë rezulton 85,185,539 lekë. Kjo vlerë nuk rakordon me vlerën e granteve të brendshme kapitale, me të cilën krijon një diferencë prej 511,408 lekë, e mbartur kjo edhe në pasqyrat financiare të vitin 2020. *.(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/d faqen 48 të Raportit të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat duke kryer veprimet përkatëse për sistemimin dhe saktësimin e vlerës në vijimësi dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare/formatet përkatëse për vitin 2020.

Në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pyetësi dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në informacionin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2018 dhe 2019, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive “po” ose “jo”, ashtu edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse, në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/e faqen 49 të Raportit të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësi dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në vijimësi



7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Prokuroria e Përgjithshme ka hartuar si dhe miratuar nga PP, Rregulloren e brendshme të institucionit me urdhrin nr. 235 datë 02.11.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”, nga ku rezultoi se nuk janë reflektuar ndryshimet të cilat kanë ardhur si rezultat i ndryshimit të organikës me urdhrin nr. 29, datë 03.02.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për disa ndryshime ne urdhrin Nr. 22, datë 07.02.2019 “Mbi Strukturën dhe Organikën e PP”. Mos reflektimi i tyre mbart paqartësi në përshkrimet e punës, trajtimin dhe ndarjen e detyrave, përgjegjësive të secilit pozicion pune për secilën drejtori apo sektor, si edhe kriteret mbi të cilat vlerësohet puna e gjithsecilit. (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën 1/b faqe 36-37 të Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Prokuroria e Përgjithshme në kuadër të ndryshime të strukturës të miratuar me urdhrin e sipërpërmendur të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm, të marrë masa për hartimin e përshkrimeve të punës, trajtimin e detyrave dhe përgjegjësive të secilit pozicion pune për secilën drejtori apo sektor, konkretisht: Zëvendës Prokuror i Përgjithshëm, Drejtoria e Koordinimit Institucional së bashku me Sektorin e Koordinimit dhe Studimeve, Sektorin e Dekriminalizimit, Sektorin e Monitorimit si dhe për Drejtorinë Gjyqësore, për të cilën janë shtuar disa pozicione te reja pune.

Brenda datës 31.03.2021

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi”

ANEKS I

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2018 ka marrë në konsideratë pragu e materialitetit prej 2%, vlerën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

4,621,953 lekë, dhe për vitin 2019 ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, vlerën **5,954,179** lekë për tu konsideruar pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti.

Mbi transaksionet u aplikuan:

- teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);

Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
- Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Prokuroria e Përgjithshme			
Emërtimi i Shpenzimeve 2018	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	131,216,890	0.70	25
Sigurime Shoqërore (601)	18,157,744	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	80,891,274	0.70	15
Investime të brend. (230-231)	0	2.00	0
Te tjera transfer. korrente (606)	831,761	0.70	0
Total	231,097,669		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	4,621,953		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	4,621,953		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	462,195		
Nëntotali	4,159,758		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	3,743,782		

Emërtimi i Shpenzimeve 2019	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	193,818,306	0.70	28
Sigurime Shoqërore (601)	21,770,849	0.70	3
Mallra e Shërbime (602)	81,491,856	0.70	12
Investime të brend. (230-231)	0	2.00	0
Te tjera transfer. korrente (606)	627,960	0.70	0
Total	297,708,971		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	5,954,179		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	5,954,179		



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Gabimi i lejuar (10% - 20%)	595,418
Nëntotali	5,358,761
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%
Vlera e precizionit	4,822,885

ANEKSI II:

LLOJET E OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Baza për Opinionin

a. Manuali i auditimit financiar të KLSH.

Audituesi duhet të shprehë një **opinion të pamodifikuar** mbi ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve kur audituesi konkludon se transaksionet përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator që zbatohet për transaksione të tilla.

Një **opinion i pakualifikuar** (pa rezervë) jepet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se:

- pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi;
- pasqyrat janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse;
- situata e paraqitur nga pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e audituesit mbi njësine publike të audituar; dhe
- janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.

Opinion i me rezerve. Opinioni me rezerve do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Formulimi i opinionit zakonisht tregon një rezultat të kënaqshëm të subjektit të auditimit në një deklaratë të qartë dhe koncize të çështjeve të mospajtimit ose të pasigurisë, duke çuar në opinionin me rezerve. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

Opinion i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

- kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose
- kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

Opinion negativ (kundërshtues). Opinioni negativ (kundërshtues) do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, si pasojë e mospërputhjes aq shumë vendimtare sa të përmbys situatën e paraqitur në atë masë që një opinion me rezerve në aspekte të caktuara nuk do të ishte i përshtatshëm. Formulimi i këtij opinion qartëson faktin se pasqyrat financiare nuk janë deklaruar saktësisht duke specifikuar në mënyrë të thjeshtë dhe koncize të gjitha rastet e mospërputhjes. Gjithashtu, aty ku është me vend dhe është e mundur, do të ishte e dobishme sikur ndikimi financiar mbi pasqyrat financiare të përcaktohej në shumë.

Refuzim i opinionit. Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë.

**ANEKSI III:****AUDITIMI I DETYRIMEVE** (Të tjera operatione me shtetin).

(Bazuar në klasifikimin ekonomik të llogarive të planit kontabël publik, Ministria e Financave).

Llogarite e marrëdhënieve me shtetin (42 e 43).

Në marrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike për sektorin publik buxhetor.

- llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin debitor”

- llogaria 4341 “Të tjera operatione me shtetin kreditor”

Llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin debitor” është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore por ende të papaguara. Raste të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm këto) si; pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat, që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor por paguhet nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Nëse veprimi kontabël:

- a. Është bërë gjatë konstatimit të shpenzimit veprimi;
 - debi llogarite respektive të klasës 6 “shpenzime korrente”,
 - kredi llogarite e detyrimeve afat shkurtër për konstatimin e detyrimit (42,43,40, e tjera).
- b. Në fund të periudhës ushtrimore është bërë veprimi;
 - debi llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin debitor”
 - kredi llogari 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”
- c. Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës është bërë veprimi;
 - debi llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4)
 - kredi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.
- d. Paralel me veprimin e mësipërm nëse është artikuluar veprimi tjetër;
 - debi llogaria 476 “Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”
 - kredi llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin debitor”;

Llogaria 4341 “Të tjera operatione me shtetin kreditor”, është një llogari që në pasqyrat financiare të sektorit publik paraqitet në pasiv në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuar e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme.

Nëse veprimi kontabël:

- a. Është bërë konkretisht kur më parë ka ndodhur situata për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes buxhet apo institucion);
 - debi llogaria 411/468, “klientë e llogari të ngjashme” apo “debitorë të ndryshëm”,
 - kredi llogarite respektive të klasës 7, të ardhura të konstatuar.
- b. Kur e ardhura në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi;
 - debi llogaria 8424 “Transferim për debitorë të konstatuar të ngjashëm”,
 - kredi llogaria 4341 “Të tjera operatione me shtetin kreditor”,
- c. Në momentin kur arkëtohet e ardhura është kryer veprimi;
 - debi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”;
 - kredi llogaria 411/468, “klientë e llogari të ngjashme” apo “debitorë të ndryshëm”,
- d. Me qenë se e drejta u arkëtua dhe llogaria 520 është llogari e thesarit nëse në fund të periudhave përkatëse është bërë veprimi përkatës;
 - debi llogaria 4341 “Të tjera operatione me shtetin kreditor”,
 - kredi llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” (për mbylljen e kësaj pjese).

ANEKSI IV:**AUDITIMI I DETYRIMEVE**



(Bazuar në klasifikimin ekonomik të llogarive të planit kontabël publik, Ministria e Financave).

Llogaria 45 *“Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”.*

Ky grup llogarish përfaqëson specifikat që shoqërojnë marrëdhëniet e institucioneve me njëra tjetrën dhe me të tjerë të tretë për xhirimet materiale në natyrë.

Nga pikëpamja e kontabilitetit institucionet e lidhura auditohen nëse përgjithësisht kanë përdorur skemën si me poshtë;

a. Institucioni dhënës i cili ka kryer blerjet mbi bazën e fondeve të akorduara sipas skemës së zakonshme të buxhetimit, përveç veprimeve që lidhen me blerjen e operacionet e tjera buxhetore, nëse i ka bërë hyrje materialet e blera.

- Debi llogaritë e klasës 3 në kredi të llogarisë 63 *“Ndryshim i gjendjeve të inventarit”.*

b. Institucioni dhënës për daljet pa pagesë që u bën njërive vartëse apo të tretëve nëse;

- Krediton llogaritë përkatëse të klasës 3 me kundër parti debitin e llogarive të grupit 45 *“Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”.*

c. Institucioni dhënës nëse ka mbyllur llogarinë 45 pas marrjes së konfirmimit nga institucioni përfitues dhe ka;

- debituar llogarinë 63 *“Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”* në kredi të grupit 45 *“Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”.*

d. Institucioni marrës i këtyre vlerave nëse i ka bërë hyrje ato duhet të;

- debitojë llogarite përkatëse të klasës 3 me kundër parti kreditimin e llogarisë së grupit 45 *“Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”.*

e. Institucioni marrës nëse e ka mbyllur llogarinë 45 *“marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”* me dërgimin e konfirmimit në institucionin dhënës dhe të debitojë këtë llogari në kredi të llogarisë 63 *“Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.*

f. Llogaria 45 *“Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit”* në fund të periudhës ushtrimor duhet të rakordohet dhe, si rregull, duhet të jetë e mbyllur.

Llogaria 466 *“Kreditorë për Mjete në ruajtje”.*

Është llogari specifike në sektorin publik.

Në kredi të saj regjistrohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve të cilat në një periudhë tjetër do t'u kthehen nga kjo llogari të treteve.

Të tilla mund të jenë:

- mjetet e xhiruara për llogari të zyrës së përmbarimit,
- paradhëniet e paguara nga të tretet për pjesëmarrje në ankande,
- garancitë bankare të ndryshme,
- të hyra për llogari të komisionit të kthimit e kompensimit të pronave,
- derdhjet e ndryshme të bëra gabim dhe që duhet të rikthehen,
- depozitime të kontributeve në avancë apo ndonjë depozitim tjetër,
- rimbursimi i tvsh nga llogaria e tatimeve,
- etj.

Llogaria 476 *“Të ardhura të përcaktuara për tu përdorur”*, përdoret si llogari kalkulative gjatë vitit ushtrimor.

Veprimet e mundshme në kontabilitet me këtë llogari janë;

- Debi llogaria 520 *“Disponibilitete në thesar”* në kredi të llogarisë 476, për akordimin e fondeve buxhetore.
- Debi llogaria 476 (ose kredi me stornim) në kredi të llogarisë 520 (ose debi me stornim) për fondet buxhetore të pa përdorura në fund të periudhës ushtrimore dhe që nuk trashëgohen për vitin e ardhshëm.
- Debi llogaria 476 në kredi të llogarisë 105, *“Grante të brendshme kapitale”* apo në kredi të llogarisë 720 *“Grante korrente të përgjithshme”* lidhur me përdorimet e këtyre fondeve respektivisht për investime e për shpenzime funksionimi.
- Debi llogaria 476 në kredi të llogarisë 4342, paralel me pagesën e bërë për shlyerje detyrimesh të vitit të mëparshëm me fondet e akorduara të vitit ushtrimor.



Llogaria 481 “*Shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime*”, karakteristike kryesisht për institucionet e vetëqeverisjes vendore. Është llogari rregulluese ku përfshihen shpenzimet e kryera për riparimet e mëdha, shpenzimet për punime parapërgatitore të një lloji veprimtarie, shpenzime të kryera gjatë vitit ushtrimor (që nuk përfshihen në aktivet e qëndrueshme dhe nuk mund të rëndohen tërësisht në rezultatin e ushtrimit). Këto shpenzime shpërndahen (amortizohen) në vitet e ardhshme.

Llogaria 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*”. Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Përfaqësojnë shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një ushtrim të ardhshëm (shpenzime të parapaguara), si p.sh. qira të paguara në avancë, prime të sigurimeve për rreziqe të paguara avancë, e tjera.

Llogaria 475 “*Të ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhëse*” e cila hyn në grupin e llogarive rregulluese. Sipas rastit të çdo institucioni evidentohen të ardhurat që janë arkëtuar përpara ngjarjes ose veprimit që krijon të ardhura.

Llogaria 478 “*Diferenca konvertimi -pasive*” pasqyron diferencat pasive që lidhen me konvertimet që rezultojnë nga vlerësimi me kurset e këmbimit në mbyllje të ushtrimit (të kërkesave debitore dhe detyrimeve) të shprehura në monedha të huaja.

Llogaria 480 “*Të ardhura për t’u klasifikuar ose për tu rregulluar*” pasqyron të ardhura të arkëtuara, por me dokumentacion të pa plotësuar ose të paqartë deri në datën e mbylljes së bilancit kontabël të institucionit. Teprica kreditore e kësaj llogarie kërkon sqarime në të dhënat shpjeguese.

Llogaria 487 “*Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së urdhrit*” regjistron të ardhurat e arkëtuara, të cilat ekzistojnë në institucion të derdhura por nuk është marrë konfirmim nga Thesari deri në fund të periudhës ushtrimore.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT AUDITIMI NË PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Nr	Urdher I P.P	Vendimi I Gjykates	Urdher shpenzimi,Nr.Date	Shuma e likuiduar
1	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 A.H
2	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 A.DH
3	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 A.H
4	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 E.M
5	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 F.B
6	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 G.S
7	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 Gj.C
8	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 L.T
9	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 P.C
10	Nr.11,dt.21.01.2020	4201,dt.12.12.2019	Nr 33, dt 04.02.2020 Nr 111, dt 06.05.2020	785,365 Xh.M